



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 30.09.2024

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 20.1, te Kushteve te Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës, lidhur me kontratën me numër identifikimi 632-24-3491-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-24-048-225 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-5866, më dt. 30.09.2024, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak se Zyra e prokurimit me dt.10.07.2024, ka pranuar Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së nr.2024/0363,të dt.10.07.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale “ , Nr. i prokurimit- 632-23-14124-2-1-1, i cili Vendim është në favor të Autoritetit kontraktues, me çka nënkupton se Autoriteti kontraktues, mund të lidhë kontratën e rregullt për këtë aktivitet, kontrata e lidhur me dt.17.04.2024, me numër te prokurimit: 632-24-3491-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-24-048-225 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-5866, me titull “: “Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale” ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve "CAPITAL X FET " SH.P.K., rr.Martirët Dushi 11, Klinë, NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, në pajtim *nenin 2.1 (te pjesa e parë e kontratës), nenin 12.3, të kushteve të veçanta,* nenin 20.1 te Kushteve te Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe rekomandimin e Menaxherit të kontratës kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.
3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit , ka iniciuar aktivitetin për Mirëmbajtja higjienike e objekteve Komunale”, me numër identifikues: 632-24-3491-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-24-048-225, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të shërbimeve "CAPITAL X FET " SH.P.K., rr.Martirët Dushi 11, Klinë, për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtaari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 112/02-5898, të dt. 18.04.2024, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejte te Menaxherit te Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësiive të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike ne Zyrën e Prokurimit me date 26.07.2024, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës .

Me date 10.09.2024, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për përfundim të kontratës” te kryesi i shërbimeve "CAPITAL X FET " SH.P.K., rr.Martirët Dushi 11, Klinë.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave te Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini



Kryetari i Komunës



Faton Gutaj



Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

- Operatorit Ekonomik;
- Zyrës së Kryetarit te Komunës;
- Drejtorisë për Punët e Përgjithshme Administrative;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Menaxherit të kontratës;
- Arkivës së Komunës.